

RREGULLORE NR. 2005/13

**MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME SHOQËRORE QË ADMINISTROHET NGA KOMUNAT NË
KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, në veçanti nenin 8.1 (q) dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 të datës 11 gusht 2000 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë,

Me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik në Kosovë,

Pas konsultimit me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë dhe pas këshillimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Përkufizimet

“Bartës i së drejtës” është personi ose subjekti juridik apo fizik i regjistruar në mënyrën e duhur në librat kadastralë ose në dokumentet tjera titullare të vërtetuara në gjykatë si bartës i së drejtës për shfrytëzim në lidhje me pronën ose si posedues i pronës.

“Pronë” është toka, duke përfshirë ndonjë strukturë mbi atë dhe ndonjë pjesë të saj, e klasifikuar si pronë e paluajtshme shoqërore në përputhje me ligjin në fuqi.

“Afat” është periudha deri në nëntëdhjetë e nëntë vjet prej datës së dhënies në shfrytëzim të pronës nga ana e ndonjë komune.

Neni 2

Dhënia e pronës në shfrytëzim afatgjatë

2.1 Varësisht nga autorizimi paraprak me shkrim i autoritetit qendror për çfarëdo dhënie të pronës në shfrytëzim për të cilën kohëzgjatja e afatit të shfrytëzimit është më shumë se dhjetë vjet, komuna autorizohet që cilëndo pronë për të cilën ajo është bartëse e së drejtës t’ia jep në shfrytëzim ndonjë personi ose subjekti fizik apo juridik për aq kohë za zgjat afati .

2.2 Autoriteti qendror i autorizon vetëm ato prona që I jepen në shfrytëzim ndonjë personi ose subjekti, nëse komuna e ka bërë përzgjedhjen e atij personi ose subjekti me anë të procedurave jodiskriminuese, të hapura, transparente dhe të drejta në përputhje me Ligjin për prokurimet publike në Kosovë - Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/3. Të gjitha të ardhurat që i shtohen komunës nga dhënia në shfrytëzim konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave të Ligjit të ndryshuar për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë - Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/17.

2.3 Secila pronë e dhënë në shfrytëzim regjistrohet zyrtarisht nga komuna në emër të përfituesit si bartës i së drejtës në pronë për aq kohë sa zgjat afati.

Neni 3

Posedimi i kundërligjshëm

Bartësi i së drejtës mbi pronën e dhënë në shfrytëzim nga komuna në pajtim me nenin 2 më sipër ka të drejtë që të largojë ndonjë posedues të kundërligjshëm nga ajo pronë dhe të marrë kompensimin për dëmet e shkaktuara nga poseduesi i kundërligjshëm në përputhje me ligjin në fuqi për mbrojtjen e pronarëve të pasurisë së patundshme.

Neni 4

Ndryshimet fizike

4.1 Ndryshimet fizike në pronën e dhënë në shfrytëzim nga komuna në pajtim me nenin 2, duke përfshirë ndonjë ndërtim në të, nuk ndikojnë në kohëzgjatjen e afatit për të cilin ajo pronë është dhënë në shfrytëzim.

4.2 Të drejtat e komunës apo të bartësit të së drejtës mbi pronën e dhënë në shfrytëzim nga komuna në pajtim me nenin 2 nuk cenohen nga ndryshimet fizike në atë pronë ose nga ndonjë ndërtesë apo strukturë e ngritur në atë pronë.

Neni 5
Skadimi i afatit

Pas skadimit ose ndërprerjes së parakohshme të afatit të dhënies së pronës në shfrytëzim, e drejta e shfrytëzimit ose e posedimit të pronës i kthehet komunës, kurse përfituesi i dhënies në shfrytëzim ia kthen pronën e poseduar komunës pa bërë ndonjë kërkesë ose pa kërkuar ndonjë të drejtë përkitazi me përmirësimet e bëra në atë pronë. Në fund të afatit shënohet përfundimi i dhënies në shfrytëzim në librat përkatës zyrtarë.

Neni 6
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 7
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 4 mars 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm